

Përmbyllen me sukses “Ditët e Informimit” për programin Erasmus+EU në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani”

Organizimi i "Ditëve të Informimit" për programin e suksesshëm të mobiliteteve Erasmus+, në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", prej vitesh ka rezultuar një mundësi e shkëlqyer për studentët, për t'u njohur me avantazhet që ofron ky program, procedurat dhe dokumentacionin e nevojshëm për të aplikuar.

Gjatë këtyre takimeve, ata patën mundësinë të diskutojnë drejtpërdrejt me përfaqësuesit e Zyrës së Marrëdhënieve me Jashtë, të cilët ofruan mbështetje të vazhdueshme për studentët e interesuar për t'u informuar apo për t'u bërë pjesë e eksperiencës Erasmus+.

Studentët u njohën nga afër, gjithashtu me projektet e ndryshme që universiteti ka fituar për ngritjen e kapaciteteve dhe përfitimet e këtyre projekteve, si në nivel institucional ashtu edhe në përvojën studentore.

Ndonëse takimet informuese në kuadër të Programit Erasmus+ u përmbyllën, ju kujtojmë se Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë është gjithmonë në dispozicion për t'ju informuar mbi thirrjet e vazhdueshme për mobilitete dhe për çdo pyetje apo informacion që mund të keni.



